

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 17.01.2023

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % jo më shumë se një vit” ndaj prokurorit L.M.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor me iniciativë të ankuesit (Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë), ndaj magjistratit L.M., me detyrë prokuror Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për moskryerje dhe zvarritje në kryerjen e hetimeve mbi kallëzimin penal mbi disa postime me përmbytje që nxisin urrejtje fetare.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor ndaj prokurorit L.M., rezulton se:

- Nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor janë kryer veprime/mosveprime, në shkelje të legjislacionit procedural penal, në drejtim të zvarritjes së pajustificuar të veprimeve dhe/ose akteve procedurale tej afateve të arsyeshme hetimore, të konstatuara gjatë hetimeve paraprake në 10 procedime penale në harkun kohor 2019-2021, kryesisht për vepra penale jo me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që kanë cënuar marrëdhënie juridike të vendosura në Republikën e Shqipërisë që mbrojnë, pronën, jetën, shëndetin, nderin, dhe rendin kushtetues
- Nga të dhënat e hetimit disiplinor nuk rezultoi ndonjë situatë, që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë, por vlerësohet, në kryerjen e shkeljes disiplinore, që ka të bëjë me zvarritje në kryerjen e veprimeve hetimore e procedurale gjatë ushtrimit të funksionit, marrja në konsideratë dhe e ngarkesës që magjistrati L.M. ka pasur si prokuror dhe si drejtues i prokurorisë gjatë vitit 2020-2021.
- Sjellja e magjistratit ka qenë pasive. Gjatë hetimit disiplinor nuk është shfaqur asnjë pretendim apo kërkesë nga ana e tij.
- Sjellja e papërshtatshme e magjistratit subjekt hetimi disiplinor, nuk shtrihet vetëm tek magjistrati konkret, por krijon terren për sjellje të papërshtatshme edhe në raste të tjera të ngjashme. Standardi i gabuar i sjelljes së prokurorit mund të ndiqet edhe nga magjistratë të tjerë, duke cënuar imazhin e prokurorit dhe ulur besimin e publikut tek prokurori si figura procedurale që ushtron ndjekjen penale.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja i) dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016, për magjistratin L.M., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar